



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.82

2005

3 nëntor

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.649, datë 17.10.2005	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2005, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për shpërblimin e sportistëve, që morën pjesë në kampionatin europian të peshëngritjes për të rinj, në Sllovaki.....	2695
Vendim i KM nr.653, datë 17.10.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.8, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore”, të ndryshuar....	2695
Vendim i KM nr.657, datë 17.10.2005	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimet nr.280, datë 16.4.2004 “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Durrësit” dhe nr.283, datë 16.4.2004 “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit të Lezhës” të Këshillit të Ministrave, si dhe për shfuqizimin e vendimit nr.284, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Krujë-Kurbin”.....	2696
Vendim i KM nr.659, datë 17.10.2005	Për Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale	2697
Vendim i KM nr.660, datë 17.10.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.343, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, të ndryshuar.....	2723

VENDIM
Nr.649, datë 17.10.2005

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2005, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE PËR SHPËRBLIMIN E SPORTISTËVE, QË MORËN PJESË NË KAMPIONATIN EUROPIAN TË PESHËNGRITJES PËR TË RINJ, NË SLLOVAKI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 10 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në buxhetin e vitit 2005, në zërin “Grant për sportin cilësor”, t’i shtohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e sportistëve të peshëngritjes, për rezultatet e larta të arritura në kampionatin europian të peshëngritjes për të rinj, të zhvilluar në Sllovaki, në datat 1-8 tetor 2005.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të përcaktojë masën e shpërblimit për sportistët, që kanë fituar medalje dhe për trajnerët e tyre.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.653, datë 17.10.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.8, DATË 5.1.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT SHTETËROR TË LUFTËS KUNDËR TRAFIKUT TË QENIEVE NJERËZORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 124 e 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.8, datë 5.1.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, fjalët “Ministër i Shtetit-kryetar” zëvendësohen me “Ministër i Brendshëm-kryetar” dhe fjalët “Zëvendësministër i Rendit Publik-anëtar”, zëvendësohen me “Zëvendësministër i Brendshëm, për luftën kundër trafikeve-koordinator”.

b) Pika 3, shfuqizohet.

2. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Komiteti Shtetëror i Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore, të paraqesë pranë Këshillit të Ministrave propozime për përmirësimin e Strategjisë Kombëtare të Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore.

3. Ngarkohet Komiteti Shtetëror i Luftës kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore për zbatimin e

këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.657, datë 17.10.2005

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMET NR.280, DATË 16.4.2004 “PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË DURRËSIT” DHE NR.283, DATË 16.4.2004 “PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT TË LEZHËS” TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, SI DHE PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.284, DATË 16.4.2004 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT KRUJË-KURBIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 35 e 41 të ligjit nr.8518, datë 30.7.1999 “Për ujëtimin dhe kullimin”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

A. Në vendimin nr.280, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit të ndryshohet si më poshtë vijon:

“PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT DURRËS-KRUJË”.

2. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Durrës-Krujë, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.”.

3. Pas shkronjës “f” të pikës 2, të shtohen shkronjat “g”, “gj”, “h”, “i”, “j”, “k” e “l” me këtë përmbajtje:

“g) zona e fushës që kullon me KUL, Thumanë-Borizanë (KRK- 1, KRK-2), me sipërfaqe 2130 ha;

gj) zona e kënetës Borizanë-Thumanë (KRK-3), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 1591 ha;

h) zona e fushës, që kullon me përroin Bardharë (KRK-4), me sipërfaqe 1499 ha;

i) zona e fushës Bacung-Dollakë-Tapizë (KRK-5, KRK-6), me sipërfaqe 3714 ha;

j) zona e fushës Bubq-Mallkuc (KRK-7), me sipërfaqe 2567 ha;

k) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe kanalet e ujërave të larta;

l) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.”.

4. Shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3, të ndryshohen si më poshtë vijon:

“b. 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1 (një) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës;

c. 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1 (një) përfaqësues nga komunat, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës;

ç) 1 (një) përfaqësues i bashkive, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Durrësit dhe 1 (një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Krujës.”.

B. Në vendimin nr.283, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit të ndryshohet si më poshtë vijon:

“PËR NGRITJEN E BORDIT TË KULLIMIT NË ZONËN E SHËRBIMIT TË KULLIMIT LEZHË-KURBIN”.

2. Pika 1 të ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Lezhë-Kurbin, i cili të financohet nga Buxheti i Shtetit.”.

3. Pas shkronjës “e” të pikës 2, të shtohen shkronjat “ë”, “f”, “g”, “gj”, “e” “h”, me këtë përmbajtje:

“ë) zona e fushës së Thumanës (LAK-1), që kullon me ngritje mekanike, me sipërfaqe 8310 ha;

f) zona e fushës, që kullon me KUL, Gjormë-Zhejë, Mamurras-Lumi Drojë dhe KUL, Laç-Milot (LAK-2, LAK-3, LAK-4), me sipërfaqe 1193 ha;

g) zona e fushës, që kullon me KK-1, Shullaz-Fusahë, Milot-Gramëz-ALK (LAK-5), me sipërfaqe 1459 ha;

gj) pendët mbrojtëse nga përmytjet e detit, të lumenjve dhe kanalet e ujërave të larta;

h) sistemi i mbrojtjes nga gërryerjet e lumenjve dhe të përrenjve, brenda fushave të sistemuara.”.

4. Shkronjat “b”, “c” dhe “ç” të pikës 3, të ndryshohen si më poshtë vijon:

“b. 2 (dy) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues nga federatat dhe shoqatat e përdoruesve të ujit, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Kurbinit;

c) 2 (dy) përfaqësues të komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues i komunave, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Kurbinit;

ç) 1 (një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Lezhës dhe 1 (një) përfaqësues i bashkisë, brenda zonës së shërbimit të kullimit të Kurbinit.”.

5. Në vendimet nr.280, datë 16.4.2004 dhe nr.283, datë 16.4.2004 të Këshillit të Ministrave, emërtimi “Ministri i Bujqësisë dhe i Ushqimit” të zëvendësohet me “Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit”.

6. Vendimi nr.284, datë 16.4.2004 i Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e bordit të kullimit në zonën e shërbimit të kullimit Krujë-Kurbin”, shfuqizohet.

7. Ngarkohet Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM **Nr.659, datë 17.10.2005**

PËR STANDARDET E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESIT SHOQËROR, PËR FËMIJËT NË INSTITUCIONET REZIDENCIALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 18 të ligjit nr.9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta të nxjerrë udhëzimin përkatës në zbatim të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Ministria e Brendshme dhe Ministria e Shëndetësisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

KREU I
HYRJA

I.1 Pse janë të rëndësishme Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale?

Hartimi i Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale, është një hap tjetër i rëndësishëm krahas vendosjes së Standardeve të Shërbimeve Shoqërore në Shqipëri. Kujdesi në qendrat rezidenciale për fëmijët është i përhapur në disa qendra rezidenciale. Në këto qendra kanë filluar të zhvillohen shërbime të tjera alternative. Në reformën që po zbatohet shërbimet ekzistuese duhet të garantojnë shërbime cilësore për fëmijët.

Këto standarde përbëjnë hapin e parë në këtë proces. Më pas do të hartohet gjithë dokumentacioni mbështetës dhe udhëzues. Këto zhvillime janë fryt i një bashkëpunimi të ngushtë midis autoriteteve qendrore e vendore, ofruesve të shërbimeve dhe organizatave që shprehin e mbrojnë interesat e fëmijëve.

Vendosja e standardeve për shërbimet rezidenciale për fëmijët është e rëndësishme:

Së pari, për të garantuar dhe për të zhvilluar më tej të drejtat e fëmijëve shqiptarë të sanksionuara në Kushtetutë, në legjislacionin shqiptar dhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria shqiptare, si Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, neni 54 përcaktohet se:

- Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja do të kenë një mbrojtje të veçantë nga shteti.

- Fëmijët e lindur jashtë martese do të kenë të njëjtat të drejta sikurse fëmijët e lindur nga martesa.

- Çdo fëmijë do të ketë të drejtën e mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, veçanërisht në moshë të mitur, të cilat dëmtojnë shëndetin dhe moralin, apo rrezikojnë jetën dhe zhvillimin normal të fëmijës.

Standardet e Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale, mbështeten dhe synojnë respektimin e parimeve, si: respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit; universaliteti; barazia e mundësive; e drejta për të përfituar; partneriteti; transparenca dhe paanshmëria; mosdiskriminimi; decentralizimi; pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit.

Krahas ndryshimeve ligjore në Kushtetutën e shtetit shqiptar, Kodin e Familjes, Kodin e Punës, Kodin Civil dhe atë të Procedurës Civile, Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, edhe legjislacioni për mbrojtjen shoqërore ka pësuar përmirësime të dukshme. Janë miratuar ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” dhe një sërë aktesh të tjera nënligjore, të cilat garantojnë dhe zhvillojnë më tej edhe të drejtat e fëmijëve. Hartimi dhe zbatimi i paketës së standardeve shqiptare për shërbimin rezidencial për fëmijë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me standardet e kërkuara ndërkombëtare, përbën edhe një hap të rëndësishëm në procesin e integritetit të vendit tonë në Bashkimin Europian.

Së dyti, vendosja e standardeve për shërbimin rezidencial për fëmijët do të shërbejë për të matur dhe përmirësuar cilësinë e shërbimeve rezidenciale. Në kushtet e zhvillimit edhe të sektorit privat, të OJF-ve në shërbimet rezidenciale, del e nevojshme që shteti të vendosë disa rregulla dhe standarde për cilësinë e shërbimeve, që duhen respektuar nga të gjithë ofruesit e shërbimeve, nga institucionet publike, nga organizatat jofitimprurëse (OJF) dhe nga ofrues të tjerë privatë.

Së treti, proceset decentralizuese ngarkojnë me përgjegjësi më të mëdha autoritetet vendore në lidhje me shërbimet rezidenciale.¹ Në kushtet që qarku, bashkitë dhe komunat nuk kanë përvojë në

¹ Ligji nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, Neni 17, pika 1 “Këto shërbime financohen nga buxheti qendror dhe nga buxhetet e pavarura të organeve të qeverisjes vendore. Bashkitë ose komunat administrojnë të gjitha shërbimet shoqërore për individë, që janë 2698

këtë fushë të re të veprimtarisë së tyre, vendosja e standardeve do t'i ndihmojë ata në përmbushjen e funksioneve të reja në lidhje me plotësimin e nevojave sociale të komunitetit, ku ata ushtrojnë autoritetin e tyre. Këto funksione lidhen me planifikimin, sigurimin e shërbimeve shoqërore dhe zhvillimin e rrjetit të bashkëpunimit rajonal apo lokal.

Së katërti, zbatimi i standardeve ndikon në rritjen e kapitalit social. Kapitali social në këndvështrimin praktik ka të bëjë me zhvillimin e rrjetit të bashkëpunimit dhe të burimeve shoqërore, që përfshijnë institucionet, marrëdhëniet dhe normat që formojnë sasinë dhe cilësinë e ndërveprimeve shoqërore në një shoqëri.

Qeveria shqiptare, e mbështetur edhe nga organizatat ndërkombëtare, si Banka Botërore, etj., ka hartuar Strategjinë e Shërbimeve Shoqërore (2005-2010)², si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin Ekonomik e Social (SKZHES). Objektivi i Strategjisë së Shërbimeve Shoqërore është reformimi i sistemit të përkujdesit shoqëror, për të siguruar të drejtat e fëmijëve, barazinë e mundësive dhe trajtime të barabarta në shërbimet shoqërore për fëmijët në nevojë. Për t'iu përgjigjur më mirë nevojave sociale në rritje, është e nevojshme të rritet përgjegjësia jo vetëm e njësisë të qeverisjes vendore, por e të gjithë komunitetit për angazhimin e sa më shumë aktorëve dhe burimeve në shërbimet shoqërore.

Aktualisht ka rreth 400 fëmijë të vendosur në qendrat rezidenciale në Shqipëri. Ky është një realitet që kërkon vendosjen e standardeve, si pikë referimi në shërbimet rezidenciale për fëmijët, për t'u siguruar që fëmijët të plotësojnë më mirë nevojat e tyre.

I.2 Metodologjia e përdorur për hartimin e standardeve

a) Këndvështrimi

Për ata që përgatitën standardet, sfida ka qenë që të zhvillonin standarde për shërbimet rezidenciale për fëmijët me qëllim që fëmijët e rritur jashtë familjes të gjejnë një mjedis të sigurt, që ju mundëson atyre duke lënë institucionin ose të gjejnë rrugën e tyre në shoqëri si qytetarë të përgjegjshëm dhe plotësisht të integruar në jetën e komunitetit, ose të mund të kthehen në familjet e tyre biologjike apo në familje që do të mundësojë rritjen e tyre. Në të gjitha rastet kërkohet një nivel shërbimi rezidencial që siguron përkujdes cilësor të lartë, në përshtatje me mundësitë për ofrimin e shërbimeve shoqërore në Shqipëri, që të jetë i realizueshëm në një plan afatshkurtër apo afatmesëm nga të gjithë ofruesit e shërbimeve rezidenciale për fëmijët, që garanton bazat për zhvillim të mëtejshëm dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për fëmijët, dhe që lejon një zhvillim të qëndrueshëm në një plan afatgjatë.

b) Procesi pjesëmarrës

Në procesin e hartimit të standardeve është ndjekur një proces konsultativ, i ndryshëm nga ai i përdorur për standardet e shërbimeve shoqërore. Një grup i zgjedhur me përfaqësues nga: profesionistë të të gjitha kategorive të shërbimeve për fëmijë, menaxherë, përfaqësues nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, SHSSH, konsulentë të huaj, OJF aktivë në shërbimet rezidenciale për fëmijët apo jorezidenciale, si dhe përfaqësues nga shoqata e bashkive/komunave kanë qenë aktive në procesin e hartimit të tyre. Fillimisht zbatimi i standardeve do të pilotohet për një periudhë rreth njëvjeçare. Ofruesit e shërbimeve rezidenciale për fëmijë do të marrin pjesë në diskutimet e mëtejshme për standardet gjatë vitit 2006.

c) Bazuar në praktikat më të mira të shërbimeve për fëmijët

Këto standarde do të konsiderohen si pjesë e një kuadri të gjerë dokumentacioni të hartuar për të përmirësuar shërbimet shoqërore, bazuar në praktikat më të mira të mundshme ekzistuese.

Fëmijët janë zgjedhur si grupi i parë në fokus të hartimit të standardeve specifike. Këto standarde janë hartuar mbi bazën e standardeve për shërbimet shoqërore të zhvilluara nga një grup aktorësh në 4 rajonet pilote dhe pas një procesi pilotimi prej 4 muajsh. Këto standarde përbëjnë një hap më tej në këtë proces. Standardet për shërbimet rezidenciale për fëmijët plotësojnë më mirë standardet e përgjithshme dhe përbëjnë një zhvillim të mëtejshëm të tyre në lidhje me kujdesin rezidencial për fëmijët.

Nëpërmjet akteve nënligjore si udhëzues të nxjerrë nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale

banorë të atij qyteti apo komune. Qarku administron shërbime kur ato ofrohen për individë, që u përkasin disa njësisë vendore në atë qark”.

² Në prill 2005 u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr.265, 28.4.2005 Strategjia e Shërbimeve Shoqërore (2005-2010).

dhe Shanseve të Barabarta apo Shërbimi Social Shtetëror, Manualeve, dhe dokumentacioneve të tjerë plotësues, do të lehtësohet zbatimi në praktikë i këtyre standardeve dhe zhvillimi i standardeve të tjera në përputhje me nevojat e së ardhmes. Në punën për përmirësimin e standardeve, në të ardhmen do të përdoret një bazë më e gjerë konsultimesh. Mjaft nga standardet për shërbimet rezidenciale për fëmijët janë të përshtatshme edhe për lloje të tjera shërbimesh. Standardet fokusohen në atë se çfarë presin përfituesit, fëmijët nga shërbimi rezidencial në vendin tonë, me fjalë të tjera janë të bazuara në rezultatet që shpresojnë fëmijët nga shërbimi rezidencial.

ç) Zbatimi

Gjate 12 muajve të ardhshëm do të ofrohen mundësi trajnimi në kuptimin dhe zbatimin e standardeve nga organizatat e përfshira në shërbimin rezidencial. Disa OJF me përvojë kanë organizuar trajnime me ofrues shërbimesh dhe qeverisjen vendore, për kuptimin e zbatimit e standardeve të shërbimeve shoqërore, gjatë fazës së pilotimit pas saj. Këto mund të shërbejnë edhe si pikë referimi për trajnimin e ofruesve të shërbimeve rezidenciale. Manuale të përgatitur gjatë punës për hartimin e këtyre standardeve do të sigurojnë një bazë orientimi se si të zbatohen standardet. Ato janë të përdorshme për të gjithë nëpërmjet faqes së internetit të Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale.

d) Ndërtimi i kapaciteteve

Pas fazës së pilotimit dhe përmirësimit, standardet do të zbatohen në të gjitha shërbimet rezidenciale për fëmijë publikë apo privatë. Në procesin e zbatimit të standardeve, duke përdorur metodologjinë e përcaktuar në manualët, do të kontribuohet jo vetëm në rritjen e cilësisë së shërbimit për fëmijët, por edhe në zhvillimin e kapaciteteve të të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Standardet synojnë gjithashtu të ndihmojnë institucionet rezidenciale që të bëhen më fleksibël, me të hapura që edhe ato të kontribuojnë në zhvillimin e komunitetit.

dh) Një sfidë për të ardhmen

Këto janë standarde minimale që synohet të zbatohen në të gjitha shërbimet rezidenciale për fëmijë. Shpresohet që këto institucione të shërbimeve rezidenciale për fëmijët në një periudhë të shkurtër jo vetëm që do t'i arrijnë standardet, por edhe do t'i çojnë më tej ato. Për standardet, që do të zbatohen në fazën e pilotimit, sikurse u veprua me standardet e përgjithshme të shërbimeve shoqërore, do të ketë rëndësi të madhe çdo propozim që vjen nga ofruesit që i zbatojnë ato në praktikë. Vitin e ardhshëm do të organizohet një tavolinë e rrumbullakët ku do të diskutohen rezultatet e zbatimit të standardeve për shërbimet rezidenciale për fëmijët, me qëllim përmirësimin e tyre, nëse është e mundur.

I.3 Kujt i shërbejnë standardet?

Të gjithë aktorët, që nga përfituesit deri tek ofruesit e shërbimeve rezidenciale dhe bashkëpunëtorët e tyre janë të interesuar t'i përdorin standardet.

- Fëmijët/familjet dëshirojnë të marrin një nivel të kënaqshëm shërbimesh. Prindërit dhe të afërmit e fëmijëve që ndodhen në qendrat e shërbimeve rezidenciale dhe fëmijët e rritur kanë të drejtën të informohen mbi standardet që të mund të kontribuojnë edhe ata në zbatimin e tyre.

- Ofruesit, ku përfshihen: institucionet publike, OJF-të, grupet e interesuara, ofruesit privatë dhe bashkëpunëtorët e tyre do t'i përdorin standardet si një udhërrëfyes në procesin e realizimit të shërbimeve rezidenciale.

- Organizatat që përfaqësojnë interesat e fëmijëve apo ato që merren me mbrojtjen e fëmijëve apo më gjerë me zhvillimin e të drejtave njerëzore.

- Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Shërbimi Social Shtetëror me agjencitë e tij rajonale, autoritetet vendore, ku përfshihen këshillat e qarkut, bashkisë dhe komunës do t'i përdorin standardet për licencimin, inspektimin dhe vlerësimin e shërbimeve shoqërore.

- Të gjitha autoritetet e tjera publike në nivel qendror, si Ministria e Shëndetësisë, e Arsimit, e Pushtetit Vendor, e Drejtësisë etj.

Standardet gjithashtu mund të jenë të dobishme për:

- Institucionet akademike dhe organizata të tjera të përfshira në veprimtari arsimore dhe/apo trajnuese për personelin që ushtron veprimtari në shërbimet shoqërore.

- Studjuesit që i drejtohen fushës shoqërore.

- Të tjerë si persona/biznese të interesuar apo edhe të angazhuar në fusha që ndërthuren me shërbimet shoqërore.

I.4 Çfarë fushash mbulojnë standardet?

1. Qëllimi i shërbimit dhe përshtatshmëria sipas qëllimit;
2. Plani i përkujdesjes;
3. Përgatitja për jetesë të pavarur;
4. Ushqyerja;
5. Paraqitja, veshja dhe nevojat materiale;
6. Shëndeti fizik, emocional, mendor dhe dentar;
7. Edukimi;
8. Argëtimi;
9. Ankimimi;
10. Mbrojtja nga abuzimi;
11. Mjedisi dhe akomodimi;
12. Stafi;
13. Menaxhimi.

I.5 Çfarë përmbajnë standardet?

Standardet janë konceptuar si standarde të cilësisë, në kuptimin që ato do të përdoren si mjet për të arritur dhe njëkohësisht për të vlerësuar cilësinë e shërbimit që ofrohet për fëmijët që rriten në institucionet rezidenciale, jashtë familjeve të tyre biologjike. Ato janë ndërtuar në 4 seksione. Së pari, përcaktimi i standardit që do të arrihet. Ky pasohet nga një përcaktim i rezultatit që arrihet te fëmijët nga zbatimi i standardit përkatës. Së treti, kriteret për vlerësimin e tij dhe së fundi treguesit për matjen e cilësisë së zbatimit të standardit që vlerësojnë nëse standardet janë arritur. Këta tregues do të shërbejnë edhe si bazë për inspektimin e shërbimeve rezidenciale për fëmijët. Në këtë mënyrë, të gjithë pjesëmarrësit në sistemin e shërbimeve rezidenciale për fëmijët dinë se ku duan të arrijnë me këtë lloj shërbimi dhe se si të marrin arritjet e tyre.

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
I- Shtëpia e Femijes zoteron nje deklaratë mbi qëllimin e shërbimit si edhe nje manual për femijet, që përshkruan me saktësi se çfarë kërkon të bëjë ky shërbim për femijet, si edhe mënyrën sipas të ciles ofrohet përkuqdesja.			
	Femijet udhëzohen dhe kanë njohuri se çfarë mund të presin nga shërbimi në një shtëpi të tillë, se si do të bëhet përkuqdesja ndaj tyre dhe personin përgjegjës për përkuqdesjen. Një deklaratë e qarte mbi atë se si operon ky shërbim, është e disponueshme për prinderit dhe të interesuarit e tjerë.	1. Një përkuqfizim i qartë i misionit dhe qëllimit të shtëpisë në fjalë, ku parashtrihen shërbimet që ajo ofron, është lehtësisht i dukshëm për të gjithë përdoruesit e kësaj shtëpie. 2. Prinderit, femijet, përdoruesit e shërbimeve kanë akses tek deklaratat e qëllimit, misioni dhe manuali (udhëzuesit). 3. Staf i ofron informacion lidhur me funksionimin e qendrës ose të shërbimit që do t'i ofrohet femijes. 4. Deklarata e qëllimit rishikohet përmiresohet në mënyrë periodike dhe pas kësaj vijojnë modifikimet përkatëse në dokumentat dhe praktikën e tjera	1.1 Ekziston një dokument zyrtar lidhur me Deklaratën e Qëllimit 1.2 Staf mund të demonstrojë gjatë diskutimeve që e kupton dhe mund të zbatojë politiken përkatëse të përshkruar në deklaratën e qëllimit. 2.1 Kopje të deklaratës së qëllimit janë të dukshme në të gjithë shtëpinë, & janë të disponueshme për përdoruesit si dhe në formë lehtësisht të kuptueshme edhe nga femijet. 3.1 Femijet dhe/ose të afërmit konfirmojnë se kanë marrë një kopje të deklaratës së qëllimit, që ajo është diskutuar me të, kanë marrë informacion nga stafi dhe që ato e kuptojnë atë. 3.2 Ka një rregullorë të brendshme ku përcaktohen qarte dhe hapur rregullat e jetesës në shtëpi si për femijet dhe stafin. 4.1 Dokumentat dhe aktet zyrtare tregojnë që deklarata e qëllimit është diskutuar dhe rishikuar rregullisht

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
II-Plani i perkujdesjes per secilin femije paraqet ne menyre te qarte nevojat e vleresuara te femijes, objektivat dhe aktivitetet e perkujdesjes, krijimin e mundesive per te plotesuar keto nevoja nga stafi i shtepise, dhe menyra se si do te vleresohet efektiviteti i perkujdesjes per cdo element (komponent) te planit.			
	Nevojat e femijeve vleresohen dhe plotesohen ne menyre efektive dhe te plote ne pershtatje me moshen e tyre. Planet me shkrim paraqesin menytrat se si do te plotesohen nevojat dhe si do te	1. Nje ekip personash, eshte pergjegjes per kryerjen e vleresimit te nevojave te rritjes dhe zhvillimit te femijes.	1.1. Eshte ngritur nje ekip personash, qe njeh pergjegjesite e tij lidhur me vleresimin dhe planifikimin ne fushen e kujdesit.

	zbatohen keto plane. Çdo femije konsiderohet si nje individ .	2. Ekipi ka kryer/po kryen nje vleresim te nevojave per çdo femije. 3. Eshte hartuar dhe po zbatohet nje Plan Perkujdesje per secilen femije	3.1 Eshte i disponueshem per seicilen femije si vleresimi ashtu edhe plani lidhur me perkujdesjen. 3.2 Seicili femije ka nje plan te vetin.
		4. Femija eshte pjese e procesit te vleresimit dhe planifikimit te perkujdesjes. 5. Plani i Perkujdesjes perfshin objektiva te qarta, mjetet per arritjen e objektivave, kontrollet periodike mbi progresin e bere.	4.1 Ka prova (deshmi) qe vleresimi i nevojave dhe plani jane diskutuar me femijet, prinderit/ te afermit e tyre, personin pergjegjes per femijen dhe qe jane kuptuar prej tyre. Shenohen ne dokumentat perkatese fakti kur femija/femijet, prinderit/ te afermit e tyre dhe personi pergjegjes nuk bien dakord me to. 5.1 Jane percaktuar objektiva te qarta per veprime dhe personi pergjegjes per realizimin e tyre. Ka raporte se progresi i femijes rishikohet çdo 6-muaj.
		6. Eshte caktuar nje person pergjegjes per zbatimin e planit dhe raportimin e progresit per secilin femije .	
		7. Çdo femije, pervec dosjes se planeve te ndryshme per vleresim dhe perkujdesje, ka edhe nje dosje personale, e cila permban dokumentacionin e duhur ne perputhje me legjislacionin per pranimin e femijes ne shtepi si dhe historine e tij personale.	7.1 .Punonjesi pergjegjes per femijen mund te flase me kompetence per femijen si edhe te deshmoje per situaten e femijes dhe te familjes se tij.
		8.Ekziston bashkepunim me sherbimet e tjera (publike, private , OJQ-te) per te siguruar qe nevojat e identifikuar	8.1 .Ka dokumenta qe deshmojne se gjate hartimit te planeve te perkujdesjes apo rishikimit te tyre jane kerkuar

		te femijes te plotesohen si edhe te ofrohet nje mbeshetje shtese per femijen.	informacione nga organizatat e tjera (shkollat, institucionet shendetesore, OJQ-te e tjera, etj.)
--	--	---	---

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
III-Shtepia e femijes, siguron hartimin e nje plani perгатitor per femijet qe largohen nga perkujdesja ne shtepi dhe levizin (transferohen) ne forma te tjera te perkujdesjes (integrim ne familjen natyrale, biresim, kujdestari, etj) ose ne jetese te pavarur apo gjysme te pavarur.			
	Femijet mbesheten e perгатiten per t'u larguar nga shtepia me qellimin e levizjes, zhvendosjes ne nje forme tjeter perkujdesjeje apo per te bere nje jete te pavarur ose gjysme te pavarur.	1. Nje ekip i vogel eshte pergjegjes per hartimin e planit perгатitor per largimin nga perkujdesja. 2. Staf i, femija, prinderit dhe/ose te afermit, apo te interesuar te tjere per femijen, punojne se bashku per perгатitjen e nje programi individual per femijen sipas moshes, nevojave dhe menyres se re te jeteses se femijes ne te ardhmen.	1.1 Duke filluar nga mosha, 14 vjec (ose me pare, nese femija largohet me shpejt nga institucioni) behen diskutime me femijet lidhur me te ardhmen e tyre kur do te largohen nga shtepia, po ashtu shqyrtohen me to opsionet realiste qe kane te bejne me kete te ardhme(edukimi, formimi profesional, etj). 2.1 Nese femijet do te duhet te bejne nje jete te pavarur, ne dosjet e tyre ka deshmi lidhur me diskutimet qe jane bere rreth rrezikut qe ekziston per shfrytezimin e tyre, shendetin seksual, perdorimin e droges, alkolit etj. 2.2 Femija/femijet konfirmojne qe ka pasur diskutime te tilla me ta. 2.3 Fillimisht, me punonjesin pergjegjes, organizohen aktivitetet ne menyre qe femijet te fitojne aftesi ne menaxhimin e jetes se tyre te pavarur. Te mesojne si te blejne gjerat me te

			domosdoshme, ne menyre te pavarur, si te menaxhojne buxhetin, si te pastrojne, te gatujne etj,
		3. Pergatitjet jane ne perputhje me Planin e Perkujdesjes individuale te femijes. 4.Monitorimi dhe mbeshtetja e femijes do te vazhdoje edhe pasi femija te jete larguar nga sherbimi.	4.1 Ne shtepi ka informacion per jetesen qe ben femija pasi eshte zhvendosur nga shtepia.

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
IV-Femijeve u sigurohen dhe ofrohen ushqime dhe lengje te shendetshem, te sigurte, te shumellojshem e ne sasira te mjaftueshme per moshen si dhe qe plotesojne deshirat e tyre.			
	Femijet marrin ushqime dhe lengje te shendetshme me vlere ushqyese qe plotesojne nevojat e tyre dietike ne perputhje me moshen. Femijeve me nevojave te vecanta ushqimore, u sigurohet nje diete e vecante sipas rekomandimeve te specialistit.	1.Femijet marrin nje diete te shendetshme, ushqyese dhe te ekuilibruar sipas nevojave te tyre te rritjes dhe zhvillimit dhe nevojave kulturore, fetare.	1.1 Ekziston nje menu javore qe i pershtatet moshave te femijeve, nevojave te tyre per lende ushqyese dhe kalori dhe nje menu per femijet me nevoja dietore te vecanta. Menuja ju behet e ditur femijeve , prinderve/ te afermeve apo persona ve te tjere te interesuar per femijen. 1.2 Nga diskutimet me grupe femijesh konfirmohet se ofrohet nje menu javore. 1.3 Regjistrat ku jane shenuar porosite konfirmojne jane blere rregullisht fruta dhe perime te fresketa. Jane te disponueshme fruta dhe perime te fresketa. 1.4 Jane plotesuar kushtet lidhur me shendetin, higjenen, pergatitjen dhe ruajtjen e ushqimeve. 1.5 Ka evidenca qe tregojne se ne raste te vecanta siç jane ditelindjet e

			femijeve pergatitet dicka e vecante. 1. 6 Atehere kur eshte e mundur femijeve u lihet te zgjedhin nje vakt – p.sh kjo mund te jete nje dite ne jave
		2. Lengje te shendetshme (si uji , qumeshti) sigurohen ne çdo kohe dhe ofrohen sipas kerkeses se femijeve.	2.1 Femijet dijne ku mund te gjejne lengje te shendetshme dhe zgjedhin per te pire kurdo qe kane etje.
		3. Stafi perdor teknikat e te ushqyerit qe u pershtaten fazes se zhvillimit te femijes. Stafi perkujdeses inkurajon femijet te mesojne te ushqehen vete. (Eshte e rendesishme qe foshnjat te mesohen me ushqimin e forte dhe te hane vete ne kohen e duhur) . 4. Duhet keshilluar me mjekun ne qofte se femijet vazhdimisht nuk pranojne te hane dhe kane çrregullime ne te ngrene. (asnje femije nuk duhet te ushqehet me zor)	3.1 Stafi ka njohuri per nevojat dhe teknikat e ushqimit si edhe çrregullimet ne te ngrene tek femijet 3.2. Pas moshes nje vjecare femijet nxiten te ushqehen vete dhe te pavarur, sepse kjo i nxit ata te provojne dhe mesojne ushqime te reja. Gjate kohes se ushqimit femijet mbikqyren dhe ndihmohen. Koha e ngrenes behet sa me zbavitese per femijet.
		5. Me mbeshtetjen e stafit, femijet kane te drejte per te pergatitur ushqime te lehta (zamer) dhe pije per veten e tyre. 6. Dhoma e ngrenes dhe mobiljet i pershtaten numrit, nevojave dhe moshes se femijeve. 7. Zakonisht stafi dhe femijet i hane vaktet sebashku. Vaktet sherbehen ne orare te rregullt, keshtu qe femijet e dine kohen e ngrenes.	5.1 Ka nje dhome te vecante, ose hapesire ku femijet me te rritur e perdorin si nje vend ku bejne vete kafe, çaj, etj, me ndihmen e stafit. 6.1 Vezhgohet gjate vizitave ne keto shtepi nga menaxheret ose inspektoret. 7.1 Femijet konfirmojne se stafi ha bashke me to

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
V-Shtepia ploteson nevojat per veshje dhe gjera personale te domosdoshme te femijeve.			
	Femijet vishen ne menyre te rregullt. Ata inkurajohen dhe u ofrohet mundesia per te zgjedhur vete veshjet dhe gjerat e domosdoshme personale, qe plotesojne nevojat e tyre.	1.Femijet jane ne gjendje te zgjedhin kur behet fjale per pamjen e tyre te jashtme. (rrobat, prerja e flokeve) dhe gjerat e tyre personale, duke i blere ato me mbeshtetjen e stafit. 2. Femijet duhet te jene ne gjendje apo te kene orendi te pershtatshme per te ruajtur gjerat e tyre personale. 3. Femijet duhet te inkurajohen dhe te ndihmohen nese eshte e nevojshme, per te administruar gjendjen e tyre financiare (parate e tyre). 4.Stafi keshillon femijet lidhur me perdorimin e tualetit, higjenen personale si dhe perdorimit te prodhimeve kozmetike.	1. 1 Ka evidence qe tregon se femijet jane te perfshire ne marrjen e vendimeve qe kane te bejne me paraqitjen e tyre te jashtme 1.2 Femijet nuk veshin rroba te perdorura te njeri- tjetrit. 2.1 Femijet kane hapesira ne dhomat e tyre te gjumit per te mbajtur rrobat. 2. 2 Nuk ka rroba per perdorim te perbashket. 2.3 Secili nga femijet ka nje vend personal per te mbajtur rrobat si edhe sende te tjera personale 3.1 Dokumentacioni i regjistruar (list pagesa) deshmon se femija (ose ne rastet e foshnjave, personat e caktuar) kane perfituar pagesen mujore, ne masen e percaktuar me VKM. 4.1 Ditaret ditore qe perdorin keto shtepi ose dosjet personale per secilin femije deshmojne se jane bere diskutime me femijet mbi keto tema. (zakonisht me punonjesi pergjegjes i femijes etj).

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
VI-Nevojat fizike, emocionale dhe shendetesore te secilit femije jane identifikuar dhe jane marre masat e duhura per te siguruar sherbimet mjekesore, dentare dhe sherbime te tjera qe nevojiten per te plotesuar keto nevoja. Femijet udhezohen dhe u ofrohet keshillim mbi çeshtje qe kane te bejne me shendetin dhe perkujdesjen personale			
	Femijet jetojne ne nje mjedis te shendetshem. Nevojat e tyre shendetesore jane identifikuar dhe ofrohen sherbime per t'i plotesuar keto nevoja. Tek femijet, nxiten menyra te shendetshme jetese (patja e nje shendetit te mire).	1. Çdo femije i nenshtrohet vleresimit te nevojave te tij shendetesore kur pranohet ne shtepi. 2. Staf i nxiti dhe inkurajon mirerritjen, zhvillimin, ushqyerjen dhe nje menyre jetese te shendetshme. (ushqime te shendetshme, diete e balancuar, ndergjegjesim per rreziket nga pirja e duhanit e alkolit, per higjenen personale, etj.) 3. Çdo femije, ne pershtatje me moshen, ka nje plan individual te kujdesit shendetesor, per mirerritje dhe zhvillim, qe njihet dhe zbatohet nga stafi i shtepise, ku perfshihen : - historia personale e femijes (lindja , shendetit, i familjes se tij, etj) - historia dhe ecuria e semundjeve dhe problemeve te kaluara - historia e semundjes aktuale - nderhyrje dhe trajtime te vecanta mjekesore - alergji dhe reaksion ndaj ilaceve	1.1 Te dhena te regjistruara ne keto shtepi, deshmojne se cdo femije i eshte nenshtrohet vleresimit te pare te nevojave mjekesore (kontrolleve mjekesore, te syve dhe te gojes) kur eshte pranuar ne shtepi dhe pas kesaj keto kontrole jane kryer ne menyre periodike. 2.1 Staf i ofron nje shembull te mire per jetese te shendetshme. Konsumimi i duhanit dhe alkolit brenda shtepise eshte i ndaluar. 3.1 Dokumentacion lidhur me planet individuale te shendetit. 3.2 Dokumentacion lidhur me marrëdhëniet midis shtepise ne fjalë dhe profesionisteve te fushes se shendetit, spitaleve etj, per kurimin e femijeve.

		- kontrolli i shikimit dhe degjimit - shendeti i gojes - vaksinimet e kryera - probleme te zhvillimit psikomotor (te folurit, ecja, sjellja, gjumi, probleme afektive etj.) - shenime nga kontrollet dhe progresi ne zhvillimin e femijes - perfshirja e prinderve/te afermeve te femijes ne çeshtje qe kane te bejne me shendetin. 4. Femijet me aftesi te kufizuar (sensore, fizike dhe mendore) kane te njejtat te drejta per sherbime shendetesore si femijet e tjere dhe duhet te kene akses te shërbime te specializuara per aftesine tyre te kufizuar. 5. Çdo femije deri ne moshen 1 vjecare kontrollohet cdo muaj, - gjate moshes 12 – 24 muaj behet nje vizite cdo 3 muaj, dhe - ne moshen 2-6 vjec behet nje vizite cdo 6 muaj (sipas udhezimit te MSH). - Femijet me te medhenj i nenshtrohen nje kontrolli dentar çdo 6 muaj dhe nje kontrolli mjekesor çdo 12 muaj.	4.1 Te dhenat e regjistruara individuale deshmojne ne se ka pasur nevoja te veçanta per mjekim per semundje te ndryshme (p.sh. diabeti, epilepsia etj) dhe qe nen mbikqyrjen e mjekut jane vene ne dispozicion ilaçet e duhura. 4.2 Dokumentacion lidhur me bashkepunimin me specialistet e aftesise se kufizuar per riaftësimin e femijeve. 5.1 Dokumenta qe vertetojne kontrollet periodike
--	--	--	--

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
VII-Shtepia ndjek nje politike edukimi qe synon te nxise dhe mbeshtese edukimin (shkollor) te femijeve gjate gjithe periudhes qe ata jetojne ne shtepine ne fjale.			
	Edukimi i femijeve nxitet ne menyre aktive duke u konsideruar si nje proces i rendesishem ne vetvete dhe si pjese e pergatitjes se femijeve per moshen e pjekurise	1. Personi pergjegjes per femijen e mbeshtet ate gjate periudhes se edukimit te tij shkollor. 2. Çdo femije ka nje plan edukimi qe perfshin: -objektivat - raportet e rregullta te progresit 3. Ka mjdisë studimi ku femijet mund te mesojne dhe pergatisin detyrat e tyre te shtepise. 4.Shtepia ofron ne menyre te rregullt materiale shkollore per femijet. Stafi i ndihmon dhe kontrollon përgatitjen e femijeve.	1. 1 Ka nje person pergjegjes qe pergjigjet per kete rol mbeshtetes dhe stafi e di kete gje. Punonjesi pergjegjes ose prindi/kujdestari takohen me mesuesin (ne veçanti apo sebashku) te pakten nje here ne vit per te diskutuar rreth progresit qe ka bere femija si edhe nevojat e tij edukative. Femijet e nje moshe te pershtatshme perfshihen ne keto diskutime. 1.2 Personi pergjegjes ndjek vijueshmerine e femijes ne shkolle. 2.1 Progresi i femijes ne aspektin edukativ eshte pjese perberese e procesit te vleresimit dhe permiresimit periodik te planit te perkujdesjes (shihni standardin 2) 2.2 Dosjet sipas rasteve individuale tregojne per diskutimet qe jane zhvilluar me femijen lidhur me ecurine e tij/te saj shkollore. 3.1 Gjate nje inspektimi mund te shihen femijet qe punojne dhoma studimi. 3.2 Shtepia ka nje biblioteke me libra dhe revista sipas moshes se femijeve.

			4.1 Ka evidence per ekzistencen e nje buxheti te akorduar veçanerisht per kete gje.
--	--	--	---

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
VIII- Ka mundesi te mjaftueshme per femijet per te marre pjese ne nje varg aktiviteteve te pershtatshme per te kaluar kohen e lire si dhe qe zhvillojne nevojat fizike, emocionale e sociale te femijes. Shtepia ne fjale planifikon dhe siguron burime financiare per te mbeshtetur aktivitetet e kohes se lire dhe mjediset e nevojshme per ti realizuar ato.			
	Femijet jane ne gjendje te ndjekin interesat e tyre te veçanta, te ndertojne marredhenie pozitive, te zhvillojne vetebesimin ne aftesite e tyre. Stafi mbeshtet e inkurajon femijet per t'u perfshire ne aktivitetet e kohes se lire.	1. Ekziston nje program i strukturuar i aktiviteteve te kohes se lire i disponueshem edhe per femijet. 2. Disa nga veprimtarite kohes se lire jane te disponueshme sipas moshes, nevojave, kultures, fese dhe nevojave te veçanta te femijes.	1.1 Jane te disponueshme programe te kohes se lire, te cilat perfshihen ne informacionin qe u jepet prinderve/te afermeve dhe femijeve kur ato pranohen ne institucione te tilla. 2.1 Stafi ndihmon femijet gjate periudhes se femijerise se hershme (0-5 vjec), respekton zgjedhjet e tyre per loje, i nxit, perkujdeset, i mbikqyr gjate lojes. Femijet nxiten te provojne lojra e aktivite te reja, qe stimulojne zhvillimin e tyre gjuhesor, imagjinaten dhe te menduarit, ne nje mjedis te sigurt dhe mbeshtetes. 2.2 Diskutimet me grupin e femijeve (qofte ne grup apo individualisht) tregojne nese femijeve ju eshte krijuar mundesia per tu marre me aktivitetet per te cilat ato kane vete interes apo aktivite te pershtatshme per nevojat e tyre te vecanta per zhvillim. 3.1 Ka te dhena per takime qe tregojne

		3. Femijet jane aktive ne organizimin dhe planifikimin e aktiviteve. 4. Drejtuesi i shtepise siguron burimet financiare, njerezore dhe mjediset e duhura per te mbeshtetur aktivite te kohes se lire. 5. Femijet inkurajohen per te realizuar dhe mbajtur miqesira me femije te moshes se tyre ne komunitet.	se jane zhvilluar diskutime me femijet lidhur me aktivitetet e tyre te kohes se lire. Nderkohe keto te dhena tregojne se atje ku ka qene e mundur femijet jane perfshire ne organizimin e ketyre aktiviteve. 4.1 Paisjet, lodrat, mjetet dhe mjediset per realizimin e aktiviteve sigurohen nga stafi e drejtuesi i shtepise. 5.1 Ne programin e kohes se lire duhet te perfshihen aktivite qe organizohen ne komunitet, per te nxitur marredheniet sociale. 5.2 Te nxiten vizitat ne familjet e stafit te qendres, vullnetareve qe bashke punojne me shtepine, shokeve te shkolles etj.
--	--	---	--

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
IX-Femijet dijnë dhe janë të aftë për t'u ankuar nëse nuk janë të kenaqur me ndonjë aspekt të jetesës në shtëpi. Çdo ankese trajtohet në mënyrë serioze, pa vonesë dhe i jepet një përgjigje e plotë brenda një maksimumi prej 30 ditësh. Femijet apo ankuesi, mbahen në dijeni për progresin lidhur me trajtimin e saj.			
	Çdo ankese trajtohet në mënyrë serioze e pa vonesë dhe ankuesi informohet lidhur me progresin e çështjes.	1. Ekziston një procedurë ankimi, që bën të mundur berjen e ankesave nga përdoruesit kur: - Nuk është ofruar informacion rreth planit të Përkujdesjes dhe rreth asaj se çfarë duhet të përfitojnë ato. -Nuk është hartuar asnjë Plan Përkujdesje në rastin e tyre. - Plani Përkujdesjes është hartuar pa u konsultuar me femijen dhe/ose të afermit/kujdestarin. - Nuk implementohen siç duhet Plani i Përkujdesjes, apo nuk ofrohen shërbimet e përcaktuara me parë. - Ndodhin ngjarje që shqetesojnë qëndrimin e femijes në shtëpi.	1.1 Në shtëpi gjenden fletushka të thjeshta dhe të kuptueshme për femijet, ose mënyra të tjera të informacionit, që promovojnë procedurat e ankimit dhe afatet kohore. 1.2 Ekziston një person/grup i paanshem që shqyrton të gjitha ankesat si edhe kanë kompetencën për të filluar veprimet e përshtatshme
		2. Femijeve, prindërve, të afërmeve të tyre, dhe stafit iu ofrohet një informacion lidhur me mënyrën se si bëhet ankesa. Nderkohe ata	2.1 Kopje të fletushkës lidhur me ankimin janë përfshirë në informacionin që u ofrohet

		duhet te kene te drejten ta perdorin kete pa u diskriminuar. 3. Ekzistojne te dhena per regjistrimin e sugjerimeve dhe ankesave. 4. Ankesat zgjidhen brenda periudhes se percaktuar. 5. Perdoruesit informohen per veprimin qe eshte ndermarre si pasoje e ankeses se tyre.	femijeve/prinderve perpara pranimet ne institucion. 2.2 Femijet dhe stafi kane njohuri mbi proceduren e ankimimit. 2.3 I gjithë stafi ka dijeni te plote dhe eshte i trainuar lidhur me perdorimin e procedurave te ankimimit. 3.1 Ka te dhena te regjistruara qe tregojne per ankesat qe jane bere, menyren e zgjidhjes si edhe afatet per trajtimin e tyre. 5.1 Dokumenta te regjistruara, drejtuar personit qe ben ankimimin per ta vene ne dijeni per rezultatet e arritura nga ky proces.
--	--	---	---

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
X- Ka procedura qe nxisin sigurine dhe mireqenien e femijeve dhe qe sigurojne mbrojtjen e tyre nga abuzimet. Procedurat njihen dhe kuptohen nga i gjithë stafi (perfshire stafin e ri, te vjeter, vullnetar si edhe stafin e perkohshem)			

	Mireqenia e femijeve nxitet dhe ato mbrohen nga abuzimet nderkohe qe trajtohet me kujdesin e duhur ndonje dyshim i ngritur per abuzim.	1. I gjithë stafi qe punon me femijet ka deshmi penaliteti te paster. 2. Perkufizim i qarte i termit "abuzim", kuptohet nga stafi dhe femijet 3. Ka procedura lidhur me raportimin e rasteve te "abuzimit". Po ashtu pergatitet nje plan veprimesh qe duhet te ndermerren ne rast abuzimesh.	1.1 Kontrolltet lidhur me deshmitet e penalitetit jane te paraqitura ne dosjet individuale te stafit. 2.1 Informacioni i ofruar stafit gjate emerimit te tij dhe femijeve perfshin perkufizime te qarta lidhur me ate se çfare do te thote ne kete kontekst fjala 'abuzim'. 3.1 Trainimi per stafin perfshin diskutime lidhur me situatat abusive dhe menyren se si jane trajtuar ato. Ka edhe udhezues te disponueshme per stafin. 3.2 Ekziston nje plan i qarte per veprimet qe duhet te ndermerren ne raste abuzimi. 3.3 Ka te dhena te qarta e te rregjistruara mbi incidentet e abuzimit si edhe menyren se si jane zgjidhur keto raste.
		4. Hartohet dhe zbatohet nje program terapie per te trajtuar traumat qe ka perjetuar femija qe eshte perfshire ne abuzimet . Ky program duhet te perfshije udhezime per stafin, personin pergjegjes per femijen si dhe personin abuzues.	4.1 Ne rastet e nje abuzimi te mundshem, te dhena te rregjistruara tregojne se keto jane trajtuar ne menyren e duhur nga stafi dhe se (kur eshte e nevojshme me ndihmen e nje specialisti) eshte ofruar terapia e pershtatshme per femijen. 4.2 Eshte caktuar nje person per te vizituar femijen ne menyre periodike dhe per te marre pjese ne rishikimin e trajtimit te tij/saj.
		5. Ekziston Kodi i Sjelljes dhe perkujdesjes prinderore, qe zbatohet duke pasur parasysh praktikat (eksperienca) e mira te punes me femijet.	5.1 Kodi i Sjelljes dhe perkujdesjes prinderore

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
XI-Shtëpia siguron mjedis fizik të pershtatshëm, mikpritës, të një stili shtëpiak dhe të një cilësie të mirë për fëmijet, stafin, prinderit apo personat e tjerë të interesuar, në përputhje me qëllimin dhe funksionin e saj. Shtëpia mbahet në rregull.			
	Fëmijet jetojnë në një shtëpi, të zbuluar, të mobiluar dhe të mirëmbajtur, e cila ofron lehtësira për përdorimin e mjediseve të saj dhe që u mundëson fëmijëve të mbajnë kontakte me familjet e tyre.	1. Shtëpia zbulohet dhe mobilohet për të krijuar një mjedis të këndshëm shtëpiak të pershtatshëm për numrin, gjininë dhe moshën e fëmijëve që strehohen atje. 2. Shtëpia ku jetojnë fëmijet është një vend i sigurtë. 3. Nuk ka më tepër se 6 fëmijë në dhomën e gjumit. Në dhoma fëmijet kanë një shtrat dhe pajisje shtrati të pershtatshme, vend për të ndenjur (për tu ulur), perde, apo mbulesa të tjera dritarësh, ndriçim të mjaftueshëm për të lexuar, tapet dhe mbulesa të tjera të pershtatshme dyshemeje si edhe ngrohje. Fëmijet kanë, dollapë për vendosjen e rrobave, që mund të mbyllet apo ndryshe vend të sigurtë të depozimit të gjërave të tyre personale. 4. Në ndarjen e fëmijëve në dhomat e gjumit merret parasysh mundësia për sjellje abusive. 5. Fëmijet janë të aftë dhe inkurajohen të personalizojnë dhomat e tyre të gjumit.	1.1 Tregohet kujdes që fëmijet të jetojnë mjedise të pastra, të lyera këndshëm dhe në njësi të vogla tip familjesh edhe pse shtëpia mund të jetë e madhe. 2.1 Dritaret, prizat janë të sigurta për fëmijet. Në shtëpi gjendet kutia e ndihmes së shpejte, mjetet e nevojshme për fikjen e zjarrit etj. 3.1 Fëmijet gjenden në dhoma me jo më shumë se 6 fëmijë, dhe gëzojnë një lloj intimiteti (jete private) brenda dhomave të tyre të gjumit. 3.2 Fëmijet kanë krevat, carcafe e mbulesa të pershtatshme krevati. Keto të fundit janë të pastra dhe lahen rregullisht. 3.3 Ka një dollap që mbyllet me kyç, ose e thehen ndryshe një vend i sigurtë depozitimi për sendet personale. 4.1 Fëmijet janë nëper dhoma me fëmijë të të njëjtes moshe dhe gjini. 5.1 Hapësira e tyre personale zbulohet sipas dëshirës së fëmijëve me një loder, me një pikturë të veçantë

		6. Ekziston nje dallim midis hapesires private dhe te pergjithshme te banimit ne shtepine ne fjale. 7. Ka dhoma ku femijet mund te takohen privatisht me vizitore si edhe hapesira per aktivitete private, per te luajtur, per te pushuar, te cilat nuk prekin aktivitetet e tjera te femijeve	te marre nga librat, fotografi etj. 6.1 Ka ndarje ndermjet hapsirave qe perdoren si dhoma gjumi, guzhines, dhomes se ngrënies, dhomes se studimit, lavanterise, dhomes ku femijet qendrojnë dhe luajne sebashku, banjove (etj) 7.1 Nga diskutimi me femijet rezulton se ata jane ne gjendje te takohen privatisht me vizitoret dhe punonjes te tjere qe kane interest te takohen me to. Ekzistojne hapesira loje per grupmosha te ndryshme femijesh.
--	--	--	---

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
XII- Ekziston nje dokument i cili percakton strukturen, numurin, procesin e perzgjedhjes dhe te rekrutimit te punonjesve. Nepermjet programeve te trainimit zhvillohen kompetencat e pergjithshme te stafit, si ne grup ashtu edhe individualisht, per realizimin e Deklarates se Qellimit te shtepise ne fjale (planet e perkujdesit dhe reagimin ndaj nevojave individuale te femijeve qe perdorin kete sherbim).			
	Ekziston nje perzgjedhje dhe nje ekzaminim i kujdesshem i te gjithe stafit dhe vullnetareve gjate punes me femijet. Sigurohet qe femijet perfitojne perkujdesjen dhe sherbimet e nevojshme nga nje staf kompetent.	1. Dokumenta te rregjistruar ku paraqiten struktura e stafit dhe numuri i tij, procesi i perzgjedhjes dhe rekrutimit, përshkrimi i vendit te punes, kualifikimet e nevojshme si edhe aftesite specifike qe duhet te kete stafi dhe vullnetaret ne marredheniet me femijet dhe te afermit e tyre.	1.1 Ekzistojne dokumenta qe tregojne per strukturen e stafit dhe shperndarjen e pergjegjesive ndermjet tyre. 1.2 Ka nje udhezues per stafin qe trajton çështje qe kane te bejne me menyra te ndryshme sjelljeje me

		2. I gjithë stafi, duke përfshirë edhe drejtorin e institucionit kanë përshkrimet e vendit të punës, ku deklarohen qartë përgjegjësitë, detyrat si dhe varesia hierarkike.	njerezit. 2.1 Gjate diskutimit stafi demonstroi se një mire dhe kupton udhëzuesin e sjelljes. 2.2 Stafi i një mire përshkrimet e tij të punës si edhe kupton se si përgjegjësitë që ka kontribuojnë për mirëqenien e përgjithshme të famijes. (shihni standardin 10)
		3.Proçedurat e punësimit janë në përputhje me legjislacionin në fuqi (kodi i punës)	3.1 Stafi emërohet sipas një procesi transparent. Kopje të lajmerimeve për vendin e punës si dhe të dhëna të regjistruara gjatë procesit të përzgjedhjes janë të disponueshme . 3.2 Cdo punonjës ka një kontratë pune të nënshkruar.
		4. Ofrohen programe trainimi për stafin. Trainimi i parë (trainim induksioni) lidhur me vendin e punës ofrohet për stafin e ri brenda 3 muajsh nga emërimi i tij.	4.1 Ekzistojnë paketa për trainimin e induksionit për stafin e ri 4.2 Stafi ka dijeni për mundësitë për trainim si edhe inkurajohet që të marrë pjesë në këto trainime. 4.3 Për cdo person të stafit ka nga një vërtetim për cdo trainim të kryer. Behet një identifikim periodik i nevojave për trainim që ka secili nga anëtarët e stafit.

STANDARTI	REZULTATI	KRITERET	TREGUESIT E CILESISE
XIII- Personi i regjistruar mund te provoje qe shtepia ne fjale ka stafin e duhur ne perputhje me nevojat e atyre qe banojne atje dhe qe ploteson kerkesat e Deklarates se Qellimit te kesaj shtepie			
	Aftesite e stafit i shtepise jane ne nivelin e duhur per plotesimin e nevojave te femijeve qe banojne aty, sipas kerkesave ne Deklaraten e Qellimit te shtepise.	1. Personi i regjistruar mund te provoje se shtepia po funksionon ne perputhje me Deklaraten e Qellimit te shtepise dhe qe vargu i nevojave qe duhet te plotesohen nuk eshte i tepert ne raport me funksionimin e tanishem te kesaj shtepie dhe kjo e fundit pranon femije nevojat e te cileve mund te plotesohen sipas qellimit te shtepise. 2. Personi i regjistruar harton nje plan zhvillimi, i cili njihet nga i gjithë stafi. 3. Kopjet e raporteve te inspektimit jane te disponueshem per tu pare nga stafi, klientet dhe te afermit e tyre.	1.1 Vendorsja e cdo femije ne shtepi eshte ne perputhje me nevojat e tij. 1.2 Dosjet individuale te femijeve tregojne se shtepia mund te plotesoje nevojat e tyre. 1.3 Observimet dhe te dhenat e regjistruara vertetojne se shtepia po funksionon ne perputhje me deklaraten e qellimit. 2.1 Per monitorimin nga menaxheret /inspektoret eshte i disponueshem nje plan 3 deri 5 vjeçar qe siguron vazhdimesine e funksionimit ose zhvillimin dhe financimin e shtepise ne fjale. 3.1 Jane te disponueshem per t'u pare nga stafi (ne disa raste edhe nga klientet dhe te afermit) kopje te raporteve te inspektimit.

KREU III

ARRITJA E STANDARDEVE NË PRAKTIKË

III.1 Si përdoren standardet?

Ky kapitull fokusohet në ndihmesën ndaj ofruesve të shërbimit dhe të aktorëve të tjerë—në sektorët publikë dhe privatë, për t'u njohur me standardet, dhe për të filluar zbatimin e tyre. Do të ofrohet trajnim për ofruesit e shërbimeve dhe aktorë të tjerë në zbatimin e standardeve të fëmijëve: si p.sh. njësitë e pushtetit vendor.

Eksperienca e drejtimit të standardeve të përgjithshme në rajonet e Tiranës, Durrësit, Shkodrës dhe Vlorës ka treguar që proceset për zbatimin e standardeve janë të njëjta, pavarësisht grupit të klientit dhe llojit të shërbimit të ofruar. Është e qartë që zbatimi i standardeve nuk mund të jetë një proces uniform për secilin ofrues, meqë lidhet me faktorët në mjedisin e brendshëm të ofruesve të shërbimit social (p.sh. si punojnë ata, çfarë përbërje ka stafi, çfarë praktike të kujdesit për fëmijën ofron qendra, dhe nëse qendra ka bërë diçka me standardet), po ashtu edhe me faktorët e jashtëm në komunitet, nivelin e mbështetjes, ekspertët lokalë, NJQV-të dhe SHSSH-të rajonale.

Mbi të gjitha, zbatimi i standardeve ka si qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimeve sociale. Prandaj, pika e fillimit dhe qëllimi i standardeve janë nevojat e përfituesve që shërbejnë si udhëzues gjatë procesit të zbatimit të standardeve. Shërbimet e ofruara mbi bazën e standardeve ndihmojnë për të siguruar mbështetjen e komunitetit dhe të të gjithë aktorëve që operojnë brenda tij. Njohja dhe familjarizimi i aktorëve kryesorë në sistemin e kujdesit të fëmijës në qendra rezidenciale është një nga hapat e parë në zbatimin e suksesshëm të tyre.

Asnjë nga standardet nuk mund të zbatohet siç duhet vetëm duke ndryshuar ose ndërmarrë një procedurë të re. Standardet kërkojnë një vëmendje të veçantë nga çdo aktor dhe një ndryshim në mënyrën e punës së përditshme, shpërndarjes dhe dhënies së informacionit.

A. Për ofruesit: Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”, ofruesve u kërkohet që të përdorin standardet. Qëllimi i tyre është përmirësimi i cilësisë së kujdesit për fëmijët që nuk jetojnë në mjedis familjar.

B. Për fëmijët dhe të afërmit e tyre: Fëmijët në kujdesin rezidencial, të afërmit e tyre ose kujdestarët të përdorin standardet, kështu që ata të dinë dhe të kuptojnë mënyrën për të marrë informacion për shërbimin dhe cilësinë e kujdesit që ata duhet të presin nga shërbimi rezidencial.

III.2 Forcimi i kapaciteteve

A. Manualet dhe udhëzuesit

Në mënyrë që ofruesit të ndihmohen në procesin e zbatimit të standardeve dhe të zhvillojnë kapacitetet e tyre lokale, janë përgatitur dy manuale pune³ të cilët janë përdorur për standardet e përgjithshme, por që janë dhe shumë të përshtatshme për këto standarde.

Nuk pritet që brenda periudhës pilot të gjithë ofruesit të zbatojnë të gjitha standardet. As radha për zbatimin e tyre nuk është vendosur. Lista e mëposhtme për të filluar punën, është hartuar në mënyrë të tillë që t'i japë mundësi ofruesve të fillojnë zbatimin përpara se Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, si dhe Shërbimi Social Shtetëror të hartojnë materiale të tjera udhëzuese.

Ofruesit duhet të zgjedhin se cili është standardi/ose kriteri më i përshtatshëm me të cilën ata mund të fillojnë punën.

B. Si të fillohet?⁴

1. Njihuni me standardet e reja dhe kuptoni përmbajtjen e tyre duke rishikuar dhe kontrolluar politikat kryesore, procedurat dhe dokumentacionin e qendrës dhe shërbimeve tuaja.

2. Sigurohuni së pari që stafi dhe pastaj fëmijët të njohin standartet. Fëmijët më të mëdhenj duhet të përfshihen në këtë fazë.

3. Vlerësoni sistematikisht funksionimin dhe praktikën aktuale të qendrës suaj kundrejt standardeve të reja. Ju mund të identifikoni pikat e forta dhe të dobëta.

³ Jane përgatitur dy Manuale pune të cilët do të shpërndahen në NJQV, pas miratimit të standardeve.

⁴ Kjo pjesë është marrë nga Chris Payne in 2002 bazuar në Residential Forum 1977 by Chris Payne në 2002

4. Identifikoni prioritetet e qarta për zbatimin e standarteve do të filloni (shih d më poshtë).
5. Hartoni një plan për ecjen përpara në zbatimin e standardeve duke filluar nga standardi më i thjeshtë. Nëse ju mund të siguron përshtatshmëri të plotë ose të tejkaloni kërkesat minimale atëherë jeni në rregull.

6. Zbatoni planin tuaj duke filluar me objektivat dhe prioritetet e identifikuar dhe vazhdoni të monitoroni, rishikoni dhe vlerësoni progresin (shih d më poshtë).

C. Menaxhimi i procesit të zbatimit.

Menaxhimi efektiv i ndryshimeve përfshin:

- Planifikim dhe organizim. P.sh të vendosni me stafin tuaj, se çfarë do të bëhet, mënyrën se si do të realizohet dhe kush do të jetë përgjegjës për këtë.

- Sigurinë që stafi ka në dizpozicion informacion të mjaftueshëm për të kuptuar dhe punuar në zbatimin e standardeve.

- Veprim. P.sh të vihen në veprim planet ose delegimi i tyre te persona të tjerë të aftë për të kryer punën.

- Koordinim të aktiviteteve të ndryshme që duhet të realizohen në të njëjtën kohë.

- Monitorim, p.sh. në diskutimet me stafin të kontrollohet puna e bërë.

- Rishikim dhe vlerësim, p.sh. bisedim me stafin dhe fëmijët më të mëdhenj vlerësohet nëse detyrat janë kryer siç ishin planifikuar.

- Ndryshim dhe përmirësim.

D. Ndërmarrja e veprimit duke diskutuar dhe rënë dakord me stafin dhe fëmijët e rritur për:

- Objektiva dhe qëllime të qarta;

- Afatet kohore;

- Alokimin dhe delegimin e detyrave;

- Identifikimin e personave përgjegjës për detyrat dhe afatin kohor;

Sigurimin që ata që janë përgjegjës kanë gjithashtu edhe autoritetin për të kryer detyrat e tyre;

E. Të krijosh empati me klientin (vëre vetëveten në rolin e klientit).

Pyetje që duhet t'ia bëni vetes suaj (menaxherët dhe stafi):

- A do të isha unë i lumtur të isha një fëmijë në këtë qendër rezidenciale?

- A do të isha i lumtur që fëmija im ose fëmija e një të afërmi ose shoku të rritej në këtë shtëpi?

- Pse jo?

- Çfarë duhet të bëj unë për të ndryshuar përgjigjen time?

Këshillohen të gjithë personat e përfshirë në menaxhimin dhe praktikën e ofrimit të kujdesit për fëmijën në qendër, të kuptojnë standaret dhe të fillojnë t'i përdorin ato në mënyrë pozitive për të zhvilluar shërbimet e tyre, për të përmirësuar cilësinë e kujdesit për fëmijët nën kujdesin e tyre.

III.3 Mbikëqyrja e zbatimit.

Mbikëqyrja e zbatimit të standarteve është përgjegjësi e Inspektoratit të Shërbimeve Sociale, i cili përfshin edhe 12 zyra rajonale në të gjithë vendin.

Procesi i kontrollit, i cili deri tani ka funksionuar nëpërmjet inspektimeve të fokusuara mbi praktika administrative, përcakton arritjen e standardeve si objektivi të aktivitetit të tij. Në mënyrë që të jepet ndihmesë për ngritjen e një sistemi të hapur dhe për të siguruar përshtatshmëri gjatë procesit të inspektimit dhe ofrimit të shërbimit, standardet shoqërohen me “treguesit e cilësisë”.

Këto kanë funksion të dyfishtë. Nga njëra anë lehtësojnë punën e inspektorëve në gjykimet e tyre për nivelin e realizimit të një standardi të veçantë dhe nga ana tjetër i jep menaxherëve dhe njësitëve të qeverisjes vendore tregues të qartë me të cilët ata duhet të vlerësojnë progresin e tyre gjatë zbatimit.

Vlerësimet periodike për rezultatet e Inspektoratit do të shërbejnë për të shpërndarë praktikat më të mira, të cilat ekzistojnë në kujdesin e fëmijës në qendra rezidenciale.

Për të bërë këtë, raportet e inspektimit rishikohen në nivelin qendror dhe shkëmbehen eksperiencat për të përmirësuar zhvillimin e standardeve. Në këtë mënyrë, kontrolli kuptohet më shumë si ndihmë për ofruesit e shërbimit dhe si një mjet për identifikimin e shërbimeve cilësore, të cilat mund të shërbejnë si model për rajonet e tjera.

Raportet periodike të kontrollit sigurojnë që pushteti lokal ka informacionin e nevojshëm për të identifikuar mangësitë në shërbimet sociale dhe të plotësojë detyrimet që rrjedhin nga politika e shërbimeve sociale.

Ky është një proces shumë i rëndësishëm në hartimin e planeve dhe programeve të komunitetit. Raportet e inspektimit në nivel kombëtar do të lehtësojnë planifikimin dhe dialogun midis sektorit publik dhe privat, që janë aktorët kryesorë në sistemin e kujdesit të fëmijës në qendra rezidenciale. Rezultatet e inspektimit çojnë në përmirësimin e shërbimeve në nivel kombëtar dhe shpërndarjen më të mirë të tyre sipas nevojave lokale.

Megjithatë, qëllimi kryesor i inspektimit është të përmirësojë cilësinë e shërbimeve sociale, në këtë rast kujdesin për fëmijët në qendra rezidenciale, dhe të ndihmojë në marrjen e vendimeve në qark, bashki/komuna, për blerjen dhe shpërndarjen e shërbimeve në zonat e tyre. Procesi i inspektimit ndihmon edhe për të identifikuar ndonjë pasojë të paparashikuar të politikave sociale. Prandaj, ndërsa vendosja e standardeve ofron udhëzues dhe jep treguesit e cilësisë si instrumentë në procesin e inspektimit, inspektimet në vetëvete ndihmojnë në zhvillimin e mëtejshëm të standardeve dhe rrjedhimisht edhe në cilësinë e shërbimeve.

Duke pasur në thellim të saj një sistem standardesh që masin cilësinë, del e nevojshme që procedura e kontrollit të jetë shumë dimensionale. Për këtë qëllim dhe për të rritur besueshmërinë e shërbimit të inspektimit, në grupin e inspektorëve duhet të përfshihen profesionistë që të kenë punuar më përpara në këtë shërbim apo të kenë eksperiencë për shërbimet sociale në përgjithësi.

Fakti që inspektimi përfshin aftësi vëzhguese, supozime dhe gjykime të mbështetura mbi provat e mbledhura (të cilat nuk varen nga interesat e grupeve të ndryshme), komunikim fleksibël dhe aftësi të tjera, do të thotë që trajnimi i vazhdueshëm i inspektorëve të shërbimit social është po aq i rëndësishëm sa dhe trajnimi i stafit të ofruesve të shërbimeve. Nëse inspektohet një shërbim i ofruar nga një OJF, grupi i inspektimit duhet të ketë në rradhët e tij një person me eksperiencë praktike që të ketë qenë i përfshirë në menaxhimin e një shërbimit të tillë. Inspektimet bëhen në bazë të një plani, që ka objektiva të matshme dhe që nuk është i ndikuar nga presionet politike.

VENDIM

Nr.660, datë 17.10.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.343, DATË 11.7.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAJISJEN ME NUMËR TELEFONI CELULAR TË PERSONAVE JURIDIKË, PUBLIKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” dhe të pikës 7.1 të nenit 7 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.343, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Fjalja e parë e pikës 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Përballimi, nga buxheti i institucionit, i shpenzimeve për telefoninë celulare t’u ofrohet, edhe me dalje ndërkombëtare, pa kufizim, funksionarëve të përcaktuar në shkronjën “A” të shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, ndërsa për funksionarët e përcaktuar në shkronjën “A/1”, përballimi i shpenzimeve të jetë jo më shumë 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj, për funksionarët e përmendur në shkronjën “B” të kësaj shtojce, përballimi i shpenzimeve të jetë jo më shumë se 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë në muaj dhe për funksionarët e shkronjës “C” të kësaj shtojce, përballimi i shpenzimeve të jetë jo më shumë se 40 000 (dyzet mijë) lekë në muaj.”.

2. Në shkronjën “A” të shtojcës nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, të hiqen pikat 4 e 5 dhe në fund të shtohet shkronja “A/1”, me këtë përmbajtje:

“A/1 1. Kryetari i Gjykatës Kushtetuese;

2. Kryetari i Gjykatës së Lartë.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar pranë:

- njërive postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;

- në adresën:

Bulevardi Zhan d'Ark,

pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"

Tel: 042 555 63; 267 468

Përmbajtjen e Fletores Zyrtare mund ta konsultoni edhe në adresën e internetit:

www.legjislacionishqiptar.gov.al ose www.qpz.gov.al

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:

BOTIMET:

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE (Botim,2005)	700
4.	KODI I PUNËS	500
5.	KODI I FAMILJES	450
6.	KODI CIVIL (Botim, 2005)	1000
7.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
8.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)	355
9.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (Botim,2005)	500
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim,2005)	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Botim,2005)	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500

1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 3.11.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë